



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2020:014662

Datë: 11.06.2020

Numri i dokumentit: 00956941

Pnr.50/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PEJE –DEGA ISTOG – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-Divizioni Penal, sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Arben Mustafaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Hale Ahmetaj, në lëndën penale kundër të pandehurit B. A. nga fsh. C. K Istog, i akuzuar për vepër penale “Vjedhja e shërbimeve” nga neni 314 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm me PP/II.nr.128/2020, e dt.30.01.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me **08.06.2020**, në praninë e Prokurorit të shtetit Suada Hamza, të pandehurit B. A., Gjykata të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë.11.06.2020 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **B. A.**, i lindur me ...-...-...në f.sh. C. , K. Istog, ku edhe banon, i biri i R. dhe nënës K. e gjinisë H. , i martuar, babai i pesë fëmijëve, ka të kryer tri klasë të shkollës fillore, din shkrim e lexim, punëtorë krahut, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., i nacionalitetit Egjiptas, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë nga ana e Gjykatës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë e gjërë me datë ...-...-..., ne f.sh. C. K. Istog, pikërisht në shtëpinë e tij, siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, ashtu që shmang pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyrë që konsumatorit me herët nga e dëmtuara njëtori elektrik i është i shkyçur, kështu që gjatë kontrollimit nga komisioni i autorizuar i K...-it, ditën kritike është hasur se i pandehuri ka bërë lidhje direkte në Fid me një kabull furnizues, me çka ka pamundësuar regjistrimin dhe faturimin e energjisë elektrike, dhe pa autorizim ka shpenzuar energjinë elektrike me pajisjet e përshkruara si në procesverbale me nr., me ç’ rast të dëmtuarës K... i ka shkaktuar dëm material në vlerën prej ... (..... euro e tridhjetenëntë centë),

- me çka ka kryer vepër penale, “**vjedhja e shërbimeve**” nga neni **314 par.1** të KPRK-së.

Gjykata, duke vendosur në kuptim të nenit 7,8,9,10,17,21,38,40,43,46,47,48,49,69,70,si dhe neni 314 par.1 të KPRK-së, dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366,450 të KPPRK-së,

E Gjykon me:

DENIM MË KUSHT

Ashtu që:

1. Të pandehurit **B. A.**, Gjykata i përcakton **dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqindë) euro**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, në qoftë se i pandehuri brenda afatit ligjor prej **1 (një) viti**, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë të re penale.
2. I pandehuri lirohet në tërësi nga shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor pasi që i njëjti i përket gjëndjes së dobët ekonomike, dhe njehe rit është edhe shfrytëzues i ndihmës sociale.
3. E dëmtuara Përfaqësuesi i autorizuar i K...-it, zyra në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë– Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate ka ngritë aktakuzën me PP/II.nr.128/20, e dt.30.01.2020, ndaj të pandehurit B. A. nga fsh. C. K. Istog, duke e akuzuar për veprë penale “Vjedhja e shërbimeve” nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë **08.06.2020**, në praninë e Prokurorit të Shtetit Suada Hamza dhe të pandehurit B. A., ndërsa duke vepruar në kuptim të nenit 245 të KPPRK-së, në seancën fillestare nuk i ka ftuar palët tjera.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri deklaroj se e pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohem, më vjen keq për këtë rast që më ka ndodhur, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, jetoj në kushte të dobëta ekonomike dhe nuk kam pasur mundësi që të paguaj rrymën e shpenzuar.

Lidhur me pranimin e fajësisë Gjykata kërkojë mendimin e Prokurorit të Shtetit i cili deklaroj se pajtohet me pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, një pranim i tillë ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës, i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë dhe gjendjen e tij të dobët ekonomiko-sociale të marrë si rrethanë lehtësuese, me rastin e matjes së dënimit.

Pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet, dhe mendimit të prokurorit të shtetit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata me aktvendim në procesverbal aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 248 par.1 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zhvilluar procedura e provave.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, si dhe me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit B. A., është vërtetuar se i njëjti më parë e gjërë me datë ...-...-... në f.sh. C. K. Istog, pikërisht në shtëpinë e tij, siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, ashtu që shmang pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyrë që konsumatorit me herët nga e dëmtuara njëtori elektrik i është i shkyçur, kështu që gjatë kontrollimit nga komisioni i autorizuar i K...-it, ditën kritike është hasur se i pandehuri ka bërë lidhje direkte në Fid me një

kabull furnizues, me çka ka pamundësuar regjistrimin dhe faturimin e energjisë elektrike, dhe pa autorizim ka shpenzuar energjinë elektrike me pajisjet e përshekruara si në procesverbale me nr., me ç' rast te dëmtuarës K... i ka shkaktuar dëm material në vlerën prej (n..... euro e t..... centë),

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshekruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit B. A., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Vjedhja e shërbimeve” nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka kryer veprën me dashje, pasi që ai ka qenë i vetëdijshëm për veprën penale dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës, për veprën penale me të cilën akuzohet.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 te KPRK-se.

Kështu si rrethana lehtësuese për te pandehurin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti kishte sjellje korrekte gjatë shqyrtimit fillestar dhe për me tepër e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet, duke u penduar për veprën e kryer, pastaj gjendjen e dobët ekonomiko-sociale të tij i cili të ardhurat për familjen 7 anëtaresh, i siguron nga ndihma sociale prej dhe puna e krahut, të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të të pandehurit. Rrethana rënduese gjykata nuk ka gjetur.

Andaj pas vlerësimit të gjitha rrethanave, Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 te KPK.

Duke u bazuar në nenin 453 par. 4 te KPPK-së, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta liroj nga pagesa e shpenzimeve procedurale dhe paushalli gjyqësore për faktin se është i gjendjes së dobët ekonomiko-sociale dhe shfrytëzues i ndihmës sociale, ku si dëshmi për këtë ka sjellë kohen e kartelës sociale të lëshuar nga QPS në Istog me nr. regj Andaj çdo ngarkesë materiale kundër tij do te ishte shumë e rëndë për të dhe familjen e tij 7 anëtaresh.

Komfor nenit 463 par.1 dhe 2 KPPRK-së, pala e dëmtuar për realizmin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA ISTOG
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.50/20, dt.08.06.2020

Sekretarja Juridike

Hale Ahmetaj

Gjyqtari Gjykues

Arben Mustafaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:014662
Datë: 11.06.2020
Numri i dokumentit: 00956941